

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova si kryetare e kolegjit, Gjyqtarin e EULEX-it Willem Brouwer dhe Gjyqtaren e Gjykatës Supreme Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtari ligjor i EULEX-it Holger Engelmann, duke vepruar në cilësi të procesmbajtësit.

Në lëndën penale kundër:

M.I., i lindur më xxx në fshatin xxx, Komuna e Istogut, emri i babit xxx, emri i nënës xxx, me vendbanim në Mitrovicë në rrugën xxx, inxhinier, xxx, xxx me tre fëmijë, i nacionalitetit Serb;

I akuzuar me aktakuzën PP. Nr. 48/2008, të paraqitur më 12 qershor 2012, të ndryshuar më 15 gusht 2012 për kryerjen e veprave penale në vijim:

- 1. Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme** në shkelje të nenit 259 paragrafit 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës¹ (tani e tutje: KPPK);
- 2. Thirrja për rezistencë** në shkelje të nenit 319 të KPPK-së;
- 3. Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare** në shkelje të nenit 316 paragrafit 3 të KPPK-së;
- 4. Pjesëmarrja në grup që kryen veprë penale** në shkelje të nenit 320 paragrafit 1 të KPPK-së, dhe
- 5. Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to** në shkelje të nenit 142 paragrafit 3 të KPPK-së;

Të gjitha akuzat kanë të bëjnë me ngjarjet të cilat kanë ndodhur më 14 dhe 17 mars 2008 në hapësirën përreth gjykatës në veri të Mitrovicës.

Gjyqtari për konfirmim, me vendimin KA. Nr. 207/2012, të datës 19 tetor 2012, ka hedhur poshtë akuzën **Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme** në shkelje të nenit 259 paragrafit 1 të KPP-së kundër të pandehurit **M.I.**

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 21 mars 2013 pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Prokuroria ka dorëzuar një dokument të emëruar si ‘Ndryshimi i aktakuzës, duke akuzuar të pandehurin **M.I.** për veprat penale në vijim:

¹ I lëshuar si ‘Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i nxjerrë si rregullore e UNMIK-ut 2003/25, e datës 6 korrik 2003, më vonë është riemëruar dhe ndryshuar me Ligji nr. 03/L-002, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012

1. **Pjesëmarrja në grup që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare** në shkelje të nenit 318 paragrafit 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) lidhur me veprimet e tij më 17 mars 2008;
2. **Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare** në shkelje të nenit 316 paragrafit 3 të KPK-së lidhur me veprimet e tij më 17 mars 2008;
3. **Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale** në shkelje të nenit 320 paragrafit 1 të KPK-së lidhur me veprimet e tij më 17 mars 2008 dhe
4. **Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to** në shkelje të nenit 142 paragrafit 3 të KPPK-së lidhur me veprimet e tij më 17 mars 2008.

Vepra penale **Thirrje për rezistencë** në shkelje të nenit 319 të KPPK-së nuk është përmendur në kërkesën për ndryshimin e aktakuzës. Sqarimet sa i përket 'Ndryshimi i aktakuzës' lidhur me akuzat e konfirmuara me aktvendimin për konfirmim KA. Nr. 207/2012, të datës 19 tetor 2012, është dhënë në mënyrë verbale nga Prokurori gjatë seancës së mbajtur më 21 mars 2013. (Shih më poshtë nën 'Historia e procedurës.')

Me aktgjykimin e shkallës së parë P.-K. Nr. 50/2012 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, të datës 28 mars 2013, i pandehuri **M.I.** është shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale në vijim:

Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në shkelje të nenit 316 paragrafit 3 të KPK-së;

Pjesëmarrja në grup që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në shkelje të nenit 318 paragrafit 1 të KPK-së (për veprimet më 17 mars 2008);

Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale në shkelje të nenit 320 paragrafit 1 të KPK-së dhe

Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to në shkelje të nenit 142 paragrafit 2 të KPPK-së.

Dhe është dënuar si në vijim:

1. Për **Pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare** në shkelje të nenit 316 paragrafit 3 të KPK-së, me gjashtë (6) muaj burgim,
2. Për **Pjesëmarrja në grup që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare** në shkelje të nenit 318 paragrafit 1 të KPK-së, me katër (4) muaj burgim,
3. Për **Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale** në shkelje të nenit 320 paragrafit 1 të KPK-së, me gjashtë (6) muaj burgim, dhe
4. Për **Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to** në shkelje të nenit 142 paragrafit 2 të KPK-së, me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim;

Dënimi unik i është caktuar **një (1) vit e dhjetë (10) muaj burgim**.

Ai është shpallur i pafajshëm për veprat penale në vijim:

Pjesëmarrja në grup që pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare në shkelje të nenit 318 paragrafit 1 të KPK-së (për veprimet më 17 mars 2008);

Thirrje për rezistencë në shkelje të nenit 319 të KPK-së dhe

Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to në shkelje të nenit 142 paragrafit 3 të KPK-së.

Pas ankesave të paraqitura nga Prokurori dhe në emër të pandehurit **M.I.** dhe një të bashkëpandehuri, Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë me anë të aktgjyqimit PAKR. Nr. 513/2013, të datës 28 maj 2014, ka hedhur poshtë ankesën e paraqitur nga Prokurori si të paafatshme kurse ka refuzuar ankesat e paraqitura nga i pandehuri dhe njëri i bashkëpandehur si të pabazuara, duke vërtetuar aktgjyqimin e kundërshtuar.

Duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura më 9 dhjetor 2014 nga avokati mbrojtës Lj. P. në emër të pandehurit **M.I.** kundër aktgjyqimit P.-K. Nr. 50/2012 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, të datës 28 mars 2013, dhe aktgjyqimit PAKR. Nr. 513/2013 të Gjykatës së Apelit të datës 28 maj 2014, gjithashtu duke marrë parasysh përgjigjen ndaj kërkesës të paraqitur më 12 shkurt 2015 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZPSHK);

Lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në emër të pandehurit M.I. kundër aktgjyqimit P.-K. Nr. 50/2012 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, të datës 28 mars 2013, dhe aktgjyqimit PAKR. Nr. 513/2013 të Gjykatës së Apelit të datës 28 maj 2014, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

- 1) Hetimi penal kundër të pandehurit **M.I.** dhe tre të dyshuarve të tjerë është filluar nga Prokuroria e UNMIK-ut me aktvendimin PP. 48/08 më 6 qershor 2008.
- 2) Hetimi penal kundër tre (3) të dyshuarve të tjerë është filluar me aktvendimin e datës 15 shtator 2011.

- 3) Me anë të vendimit JC/EJU/OPEJ/0615/mgc/09 të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it të datës 28 prill 2009, lënda i është caktuar një gjyqtari të procedurës paraprake të EULEX-it.
- 4) Më 12 qershor 2012, Prokurori i Qarkut ka ngritur aktakuzë pranë Gjykatës së Qarkut kundër të pandehurit dhe gjashtë (6) të bashkëpandehurve. Aktakuza është ndryshuar më 15 gusht 2012 dhe më vonë është ndryshuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 21 mars 2013.
- 5) Më 19 tetor 2012, Gjyqtari i EULEX-it për konfirmim i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ka lëshuar aktvendimin KA. Nr. 207/2012 mbi konfirmimin e aktakuzës. Njëra nga akuzat kundër të pandehurit është hedhur poshtë kurse katër (4) akuza janë konfirmuar.
- 6) Procedura e shqyrtimit gjyqësor është hapur më 26 shkurt 2013 para trupit gjykues të përbërë prej gjyqtarëve të EULEX-it të Gjykatës Themelore të Mitrovicës.
- 7) Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 21 mars 2013, prokurori ka i ka dorëzuar gjykatës një dokument të titulluar 'Ndryshim i aktakuzës' me kauza dhe rrethana faktike të përshkruara si më lart. Pas pyetjeve të kryetarit të trupit gjykues, prokurori ka sqaruar se të gjitha dokumentet e mëparshme të lidhura me akuzat mbeten të paprekura dhe se dokumenti sqaron gjendjen faktike ku ka ndryshuar. Aktakuza e ndryshuar do të përbëhet nga aktakuza e konfirmuar fillimisht së bashku me ndryshimet e paraqitura.
- 8) Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me gjithsej katërmëdhjetë (14) seanca publike përfshirë atë më 28 mars 2013 kur është shpallur aktgjykimi P.-K. Nr. 50/2012.
- 9) Më 13 gusht 2013, prokurori ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur.
- 10) Më 5 dhe 28 gusht 2013, dy (2) ankesa janë paraqitur nga avokatët mbrojtës në emër të pandehurit **M.I.** Gjithashtu edhe një i bashkëpandehur tjetër ka paraqitur ankesë.
- 11) Pas mbajtjes së seancës publike, më 28 maj 2014 Gjykata e Apelit ka lëshuar aktgjykimin PAKR Nr. 513/2013, duke hedhur poshtë ankesën e paraqitur nga prokurori si të paafatshme, duke refuzuar ankesat e mbrojtjes si të pabazuara dhe duke vërtetuar aktgjykimin e kundërshtuar të shkallës së parë.
- 12) Aktgjykimi i është dërguar të pandehurit më 19 shtator 2014.
- 13) Më 9 dhjetor 2014, avokati mbrojtës Lj.P. në emër të pandehurit **M.I.** ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të formës së prerë.
- 14) Më 12 shkurt 2015, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK) ka paraqitur përgjigjen ndaj kërkesës së të pandehurit.

II. Parashtrësat e palëve

1. Kërkesa e paraqitur nga avokati mbrojtës Lj.P. në emër të pandehurit më 9 dhjetor 2014

- 15) Në kërkesën e të pandehurit pretendohet se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë, i paqëndrueshëm dhe kundërthënës me pjesën hyrëse të aktgjykimit. Mbrojtja pretendon se i pandehuri është akuzuar vetëm për pesë (5) vepra penale kurse gjykata ka gjykuar shtatë (7) vepra penale.
- 16) Ky fakt njëkohësisht shkel në mënyrë substanciale dispozitat e procedurës penale në atë mënyrë se aktgjykimi tejkalon aktakuzën. Gjykata është dashur të shqyrtojë vetëm aktakuzën e ndryshuar më 21 (në kërkesë gabimisht: 20) mars 2013, e cila ka pasur për qëllim të zëvendësojë aktakuzën fillestare.
- 17) I pandehuri më tutje pohon se është shpallur fajtor dhe liruar për veprën e njëjtë penale Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to në shkelje të nenit 142 paragrafit 2 të KPK-së.
- 18) Një mospërputhje tjetër në dispozitiv ka të bëjë me versionin në gjuhën Serbe, ku gjoja vepra penale Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to në shkelje të nenit 142 paragrafit 3 të KPK-së, përmendet në pjesën fajësuese si dhe në pjesën liruese të aktgjykimit.
- 19) Mbrojtja pohon se video regjistrimet dhe fotografitë e të pandehurit të bëra gjatë demonstratave dhe ngjarjeve në fjalë janë të papranueshme sepse janë thelbësisht të pambështetshëm sipas nenit 259 paragrafit 2 të KPP-së, për shkak të origjinës së panjohur të provave dhe për shkak të faktit se provat nuk janë marrë në përputhje me dispozitat ligjore të cilat rregullojnë fotografimin dhe video vëzhgimin e fshehtë. Asnjëherë nuk është vërtetuar se kush ka bërë video regjistrimin dhe fotografimin në fjalë.
- 20) Në kërkesë i propozohet Gjykatës Supreme që ta ndryshojë aktgjykimin e formës së prerë në pjesën dënuese të të pandehurit **M.I.** dhe të shpallet i pafajshëm për akuzat, ose si alternativë, të anulojë pjesën e specifikuar të aktgjykimit dhe ta kthejë lëndën për rivendosje apo rigjykim në gjykatën më të ulët.

2. Përgjigja e Zyrës së Krveprokurorit të Shtetit

- 21) ZPSHK-ja në përgjigjen e saj i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzojë kërkesën e të pandehurit si të pabazuar dhe t'i vërtetojë aktgjykimet e kontestuar.
- 22) Prokurori i Shtetit vëren se shumica e argumenteve të avokatit mbrojtës tashmë janë prezantuar si arsye për ankesë dhe janë refuzuar nga Gjykata e Apelit.
- 23) Pretendimet se aktgjykimet janë bazuar në prova të papranueshme dhe se tejkalon aktakuzën tashmë janë adresuar në hollësi në mendimin e Prokurorit të Apelit të datës 5 shkurt 2014, i cili duhet të konsiderohet si pjesë integrale e përgjigjes aktuale të Prokurorisë.
- 24) Lidhur me kundërthëniet e pretenduara në versionin në gjuhën Serbe të aktgjykimit të shkallës së parë, versioni në fjalë i vendimit nuk lë asnjë dyshim se i pandehuri është shpallur fajtor për veprat penale të përshkruara në nenin 142 paragrafin 2 të KPK-së dhe është liruar për veprat penale të përshkruara në nenin 142 paragrafin 3 të KPK-së. Aktgjykimet e kundërshtuara janë të qarta, pa mospërputhje apo kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit dhe bazohen vetëm në prova të pranueshme.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

25) Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të të pandehurit **M.I.** është paraqitur me kohë, por është e pabazuar.

Sa i përket ligjit të zbatueshëm të procedurës, kolegji pajtohet me Gjykatën e Apelit se Kodi i Procedurës Penale i Kosovës² (tani e tutje: KPPK) është i zbatueshëm. Nisja e procedurës penale si dhe ngritja dhe konfirmimi i aktakuzës janë bërë kur KPPK-ja ishte ende në fuqi (para 1 janarit 2013). Duke vlerësuar se dispozitat e Dispozitive Kalimtare (Kapitulli XXXVIII, nenet 539 e tutje) të Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës³ (tani e tutje: KPPK) janë të papajtueshme dhe kundërthënëse⁴, kolegji zbaton parimin e ruajtur me nenin 545 paragrafin 1, fjalinë e parë të KPPK-së: “Vendimi nëse duhet zbatuar këtë Kod të procedurës penale bazohet në datën e ngritjes së aktakuzës” dhe në rregullën themelore se procedura penale e nisur sipas një grupi rregullash procedurale duhet të finalizohen më së miri sipas dispozitave të njëjta.

26) Kërkesa pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të formës së prerë, sa i përket të pandehurit është i paqartë, në brendi i papajtueshëm dhe kundërthënës me pjesën hyrëse të aktgjykimit. Mbrojtja pretendon se i pandehuri është akuzuar vetëm për (5) vepra penale dhe se gjykata ka gjykuar (7) vepra penale.

Kërkesa pretendon se ky fakt njëkohësisht bën shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale pasi që aktgjykimi e tejkalon aktakuzën.

27) Gjykata Supreme e Kosovës vëren se tanimë janë përdorur argumentet e njëjta si bazë për ankesën e të pandehurit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Kolegji gjen se pretendimet e përshkruara janë të pabazuara dhe konsideron se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ka adresuar çështjen në mënyrë të kënaqshme.

Nuk ekziston asnjë kundërthënie apo mospërputhje në dispozitiv, dispozitivi është i qartë dhe i kuptueshëm. Aktgjykimi nuk e tejkalon aktakuzën.

Ndryshimi i aktakuzës së ngritur më 21 mars 2013 gjatë shqyrtimit gjyqësor para Gjykatës Themelore në Mitrovicë e ka plotësuar aktakuzën e konfirmuar më parë mirëpo nuk e ka zëvendësuar atë, siç pretendon mbrojtja. Këtë e bën të qartë arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë (faqet 54 deri 61) dhe procesverbali i seancës publike të datës 21 mars 2013. Kryetari i trupit gjykues i Gjykatës Themelore pyeti pikërisht përfaqësuesin e prokurorisë a ishte kjo tërësisht aktakuzë e re apo një plotësim i aktakuzës. Prokuroria është përgjigjur duke iu referuar nenit 376 të KPPK-së (ndryshimi i gjendjes faktike) dhe ka sqaruar se të gjitha dokumentet e mëparshëm mbesin të paprekura.

Pretendimet e njëjta janë ngritur në ankesën e të pandehurit dhe Gjykata e Apelit është përgjigjur shumë saktë në aktgjykimin e saj në faqet 19 dhe 24 duke i refuzuar ato. Gjatë procedurës nuk kishte tërheqje të akuzave. Kjo i ishte bërë mjaft e qartë të pandehurit me

² I nxjerrë më 6 korrik 2003 si Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/26 dhe më 6 nëntor 2008 me Ligjin Nr. 03/L-003të ndryshuar dhe të riemëruar si Kodi i Procedurës Penale i Kosovës.

³ Ligji Nr. 04/L-123, i nxjerrë më 13 dhjetor 2012, i shpallur më 21 dhjetor 2012, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 37, 28 dhjetor 2012

⁴ Kolegji i referohet Mendimit Nr. 56/2013 të Seancës së Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 23 janar 2013, faqe 2, paragrafi 2.

sqarimin e dhënë nga prokuroria më 21 mars 2013 dhe me faktin se gjersa vepra penale e thirrjes për rezistencë nga neni 319 nuk ishte përmendur shprehimisht në ndryshimin e aktakuzës, kjo qartazi mbeti subjekti i procedurës penale i adresuar në shqyrtimin gjyqësor.

Të dy instancat e mëparshëm e kanë ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale të rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personalit në marrëdhënie me to, në përputhje me nenin 142 paragrafin 3 të KPK-së, siç përshkruhet në aktakuzë, në veprën penale nga neni 142 paragrafi 2 i KPK-së. Përshtypja se me sa duket kishte një numër më të madh të veprave penale të gjykuara se sa ishin të përmendura në aktakuzë rrjedh nga fakti se akuzat e njëjta ishin ngritur në lidhje me vepra të tjera të të pandehurit të kryera në kohë të ndryshme. Të dy aktgjykimet e instancave të mëparshme e kanë bërë mjaft të qartë se nuk kanë konstatuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri, më 14 ose më 17 mars 2008, është përfshirë në sulm të dhunshëm në objektet zyrtare, banesat private apo mjetet transportuese të Kombeve të Bashkuara apo personelit në marrëdhënie me to.

- 28) Në paragrafin 6 kërkesa po ashtu pretendon se versioni në gjuhën serbe i aktgjykimet të shkallës së parë përmbante një gabim në lidhje me dënimin e pretenduar për veprën penale të rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personalit në marrëdhënie me to, në përputhje me nenin 142 paragrafin 3 të KPK-së.

Kolegji ka rishikuar versionin në gjuhën serbe dhe konstaton se nuk përmban kundërtënie të tilla. Dispozitivi si dhe pjesa e arsytimit është i qartë dhe i qëndrueshëm. Edhe nëse versioni në gjuhën serbe kishte një gabim të tillë, kjo nuk të jep bazë për ndryshimin e aktgjykimet të formës së prerë. Pasi që versioni origjinal në gjuhën angleze nuk kishte një gabim të tillë, kjo do të cilësohet si një gabim evident tipografik dhe do të përmirësohej vetëm si *de minimus error* në përputhje me nenin 397 të KPPK-së.

- 29) Mbrojtja pretendon se video-incizimet dhe fotografitë e të pandehurit të marra gjatë demonstratave dhe ngjarjeve në pyetje janë të papranueshme, në përputhje me nenin 2 të KPPK-së, sepse janë thelbësisht të pambështetshme për shkak origjinës së panjohur të provave dhe për shkak të faktit se provat nuk janë siguruar në pajtim me dispozitat e nenit 256 dhe 267 të KPPK-së.

- 30) Kolegji gjen se ky pretendim është jo-meritor dhe pajtohet me arsyetimin e hollësishëm përkritazi me çështjen në faqet 17 deri 19 të aktgjykimet të Gjykatës së Apelit.

- 31) Gjykata Supreme fillimisht vëren se – siç është shtjelluar më lart nën paragrafin 26 – KPP-ja nuk zbatohet në rastin konkret. KPPK-ja nuk përmban dispozitë identike apo të ngjashme me nenin 259 paragrafin 2 të KPP-së.

- 32) Edhe nëse neni 259 paragrafi 2 i KPP-së do të ishte në fuqi, nuk do të vlente për provat të pyetje.

Shprehja “thelbësisht e pambështetshme” definohet në nenin 19 paragrafin 1 pikën 1.29 të KPPK-së. Edhe pse origjina e panjohur përmendet si mundësi e cila mund ta bëjë informatën “thelbësisht të pambështetshme”, në rastin konkret kjo nuk vlen. Vendi dhe koha e incizimeve është i njohur dhe nuk është kontestues. Identiteti i saktë i personit i cili i ka bërë incizimet nuk është me rëndësi për pranueshmërinë e provave.

“Thelbësisht” sipas definicionit do të thotë “që i takon natyrës thelbësore të formimit të në gjëje” (Fjalori Merriam-Webster Thesaurus). Incizimi nuk bëhet diçka e pambështetshme nga vetë natyra e tij vetëm pse identiteti i saktë i personit që ka bërë incizimin është i

panjohur.

Identiteti i saktë i personit/personave përgjegjës për incizimin në pyetje mund të bëhet i rëndësishëm kur vjen deri te vlerësimi i besueshmërisë së provave. Megjithatë, kjo është një kategori ligjore sistematike tjetër nga pranueshmëria e provave. Nuk kishte asnjë shenjë të ngatërrimit apo të manipulimit me incizimet që do të nginin dyshime lidhur me besueshmërinë e provave në pyetje dhe asnjë pretendim i tillë nuk është ngritur.

- 33) Kolegji refuzon pretendimin e mbrojtjes si të pabazuar se prova në pyetje është siguruar në kundërshtim me dispozitat e neneve 256 deri 267 të KPPK-së apo të dispozitave të tjera të procedurës penale.

Pranueshmëria e provave duhet të vlerësohet në përputhje me nenin 153 paragrafin 1 të KPPK-së (korrespondues me nenin 205 par 1, 2 dhe 4 të KPP-së). Prova është e papranueshme vetëm nëse merret në kundërshtim të dispozitave të KPPK-së apo të dispozitave të tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Definicioni në nenin 256 paragrafin 2 të KPPK-së për 'vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video' nuk vlen për incizimet që janë subjekt i pretendimit pasi që, sipas definicionit, ky 'vëzhgim' duhet të bëhet a) pa dijeninë apo pëlqimin e së paku njërit prej personave që i shtrohen kësaj mase dhe, b) duke u drejtuar ndaj personave të caktuar, lëvizjeve apo aktiviteteve të tyre.

Prova në pyetje nuk është siguruar në mënyrë të fshehtë, por në observim të hapur në zonë publike. Nuk është drejtuar apo përqendruar kundër personave të caktuar por në vend publik dhe duke synuar observimin e hapësirës publike me qëllim të parandalimit të krimit dhe për siguri publike. Neni 8 paragrafi 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) shprehimisht lejon vëzhgimin publik për qëllime të sigurisë publike dhe për parandalimin e krimit.

- 34) Gjykata nuk ka gjetur as shkelje të dispozitave të nenit 171 paragrafëve 1 ose 2 të KPPK-së.

Incizimi është bërë në vend publik. Dispozitat e përmendura mbrojnë vetëm nga cenimi i privatësisë pa marrjen e pëlqimit. Në vende publike nuk ka të drejta të mbrojtura me ligj për privatësi. Kolegji edhe një herë i referohet nenit 8 paragrafit 2 të KEDNJ-së.

Për arsyet e lartpërmendura, në përputhje me nenin 456 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës, lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, vendos si në dispozitiv.

Kryetare e kolegjit:

Elka Filcheva-Ermenkova
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtarë të kolegjit:

Willem Brouwer
Gjyqtar i EULEX-it

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Procesmbajtës:

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML.-KZZ. Nr. 26/2015
18 mars 2015
Prishtinë